

VENDIM
Nr.863, datë 20.12.2006

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TË
PËRDORË PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, ME KORPORATËN
NDËRKOMBËTARE FINANCIARE (IFC), PËR SHËRBIME KONSULENCE, PËR REALIZIMIN
E PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT DHE PRIVATIZIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT
TË SHPËRNDARJES (OSSH) TË ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që për fondin 240 000 (dyqind e dyzet mijë) USD, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me Korporatën Ndërkombëtare Financiare (IFC), për shërbime konsulence, për realizimin e procesit të rristurimit dhe privatizimit të operatorit të sistemit të shpërndarjes (OSSH) së energjisë, sipas termave të referencës dhe kushteve të marrëveshjes, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Fondi të përballohet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha